



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 17768/5 prot.

Lezhë, më: 30.01 .2024

PROJEKT-V E N D I M

Nr. _____, Datë 30.01 , 2024

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË SIPËRFAQES SË FONDIT PYJOR NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË PARASHIKUARA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR PYJET.

Bazuar në Ligjin nr.139 datë 17.12.2015" Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", VKM-në nr. 433 datë 08.06.2016 e ndryshuar me VKM-në nr 684 datë 02.09.2020 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave e Bashkive", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", i ndryshuar, në udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, date 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", në udhëzimin nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Përmbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullor kombëtar", bazuar në kërkesat e paraqitura nga subjekte të ndryshme për marrje toke pyjore në përdorim, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **8 ha** e përbërë nga sheshet e Aerogjeneratorëve dhe sipërfaqe ndihmëse që shtrihet nën helikat e Aerogjeneratorëve + **5.25 ha** sipërfaqe e rrugës me **7.62 km** gjatësi + **2.13 ha** për linjën elektrike me **3.51 km** gjatësi, që mund të jepet në përdorim dhe shtrihet në ngastrat/nëngastrat: **05b, 06a, 06b, 07c, 08c, 09c, 010e, 011e, 012b, 013d, 014b, 015c, 016d, 017f, 018b, 019d, 020d, 021c, 06b, 07b, 07a, 03d, 03c, 03b**, të cilat bëjnë pjesë në ekonominë pyjore: **Zadrimë** e shtrirë në Njësinë Administrative Blinisht dhe në

ngastrat/nëngastrat **81, 80, 78** të cilat bëjnë pjesë në ekonominë pyjore *Brinjat e Kreshtës* e shtrirë në Njësinë Administrative Ungrej, sipas Raportit Teknik, bashkangjitur.

2. Afati për dhënien në përdorim do të jetë 10 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Vlera fillestare e qirasë në vit, përfshirë edhe infrastrukturën ndihmëse do të jetë **2371410 (Dy milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e dhjetë) lek në vit.,** lek e detajuar sipas zërave.
 - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **3.1 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Trungishte **X 210000 lek/ha = 651000 lek.**
 - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **2.1 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Shkurre **X 176000 lek/ha = 369600 lek.**
 - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **2.8 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Inproduktive **X 143000 lek/ha = 400400 lek.**
 - Sipërfaqe rruge auto e shprehur në gjatesi për tu dhënë në përdorim, **2.68 km** në kategorinë përdorimit të territorit Trungishte **X 70000 lek/km = 187600 lek.**
 - Sipërfaqe rruge auto e shprehur në gjatesi për tu dhënë në përdorim, **0.79 km** në kategorinë përdorimit të territorit Cungishte **X 50000 lek/km = 39500 lek.**
 - Sipërfaqe rruge auto e shprehur në gjatesi për tu dhënë në përdorim, **1.78 km** në kategorinë përdorimit të territorit Shkurre **X 35000 lek/km = 62300 lek.**
 - Sipërfaqe rruge auto e shprehur në gjatesi për tu dhënë në përdorim, **2.37 km** në kategorinë përdorimit të territorit Inproduktive **X 25000 lek/km = 59250 lek.**
 - Sipërfaqe linje elektrike e shprehur në gjatesi për tu dhënë në përdorim, **0.27 km** në kategorinë përdorimit të territorit Trungishte **X 175000 lek/km = 47250 lek.**
 - Sipërfaqe linje elektrike e shprehur në gjatesi për tu dhënë në përdorim, **0.81 km** në kategorinë përdorimit të territorit Cungishte **X 145000 lek/km = 117450 lek.**
 - Sipërfaqe linje elektrike e shprehur në gjatesi për tu dhënë në përdorim, **2.08 km** në kategorinë përdorimit të territorit Shkurre **X 145000 lek/km = 301600 lek.**
 - Sipërfaqe linje elektrike e shprehur në gjatesi për tu dhënë në përdorim, **0.35 km** në kategorinë përdorimit të territorit Inproduktive **X 110000 lek/km = 38500 lek.**
 - Vlera e materialit drusor që pritet nga hapja e rrugëve dhe linjës elektrike, dru zjarri **161.6 m³ X 600 lek/m³ = 96960 lek.**
4. Të kryejë rehabilitim mjedisor sipas planit të rehabilitimit dhe VNM-së paraprake.
5. Proçedura për dhënien në përdorim do të zhvillohet me garë të hapur sipas akteve ligjore e nën ligjore në fuqi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Lezhë.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

Drejtoria e Bujqësisë
Drejtori: E Smaçi
Përgjegjës: A Palushi
Kopje Nr. 3

KRYETARI

Pjerin NDREU

